



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*Ex officio*  
Nr. 468/2019

*përkitazi me detyrimet pozitive në rastin e znj. Z. S., të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*

**Për:** Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror,  
Prokuroria e Shtetit  
Z. Muja Ferati, Kryetar,  
Komisioni i Pavarur për Media  
Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm,  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës  
Z. Skender Reçica, Ministër,  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Z. Agim Veliu, Kryetar  
Komuna e Podujevës

Prishtinë, më 9 dhjetor 2019

## I. QËLLIMI I RAPORTIT

- Ky raport ka për qëllimi të tërheqë vëmendjen lidhur me detyrimet pozitive që shteti ka përkitazi me garantimin e sigurisë dhe të jetës së qytetarëve si në rastin e znj. Z. S., e cila ishte sulmuar fizikisht më 29 maj 2019 në Lipjan dhe më 31 maj 2019 në Ferizaj nga disa qytetarë, krejt kjo si pasojë e nxitjes së urrejtjes në rrjetet sociale dhe nga portale të ndryshme mediale. Raporti gjithashtu tërheq vërejtjen mbi kufijtë e lirisë së shprehjes në raport me të drejtat e tjera dhe rrezikut të cenimit të privatësisë, të dinjitetit të njeriut, nxitjes së dhunës, të urrejtjes, të mosdurimit apo të prishjes së rendit publik.
- Raporti vë theksin mbi domosdoshmërinë e veprimit të institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti të organeve të rendit, qoftë edhe me veprime parandaluese që të garantohet jeta e qytetarëve të vendit dhe të sigurohet lëvizja e lirë e tyre.

### Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: *Kushtetuta*), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*”
2. Avokati i Popullit, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjera, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
  - “*Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
  - “*T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
  - “*Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
  - “*Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).
  - “*T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij Raporti me rekomandime tek institucionet kompetente, si dhe me publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura.



## Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

3. Më 31 maj 2019, Avokati i Popullit ka filluar hetimet sipas detyrës zyrtare (ex-officio), duke u bazuar në shkrimin e publikuar në portalin “KlanKosova.tv”, më 29 maj 2019, me titull: “Policia flet rreth gruas “misterioze” që u pa nëpër Kosovë”. Nëpërmjet rrjeteve sociale, por edhe nëpër disa portale në internet, u raportua se Z. S. rrëmbeu fëmijë në disa qytete, si: në Malishevë, në Prizren dhe në Fushë Kosovë. Në një video të shpërndarë në rrjetin social “Facebook” është publikuar një fotografi e një gruaje në stacionin e autobusëve në Malishevë, me mbishkrimin: “Kujdes nga kjo grua, po rrëmben fëmijët”. Kjo informatë u shpërnda shumë shpejt në shumë portale online në Kosovë, duke krijuar shqetësime të mëdha për mbarë opinionin. Në ditët në vijim, portalet online në Kosovë shpërndanë informata se personi i identifikuar në foto është mashkull, por është veshur si femër dhe dyshimet hidheshin se ky person mund të jetë transgjimor.
4. Më 28 maj 2019, portali online “Gazeta Metro” publikoi informatën se zëdhënësja e Policisë së Kosovës për rajonin e Gjakovës ka pohuar se, përderisa Z. S. ka qenë duke qëndruar në stacionin e autobusëve në Malishevë, është fotografuar nga disa të rinj (nxënës të shkollave të mesme), të cilët më pas këto fotografi me imazhin e saj i kanë postuar në rrjete sociale me qëllim humori dhe talljeje duke shkruar: “Runu ejjj Rrezik nëpër shtëpia”.<sup>1</sup>
5. Sipas informatave të IAP-së të pranuar nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), bëhet e ditur se znj. Z. S. është person i riadhesuar tri herë nga Belgjika në vitet 2011, 2014 dhe 2015. Ka qenë përfituese e disa shërbimeve të përcaktuara për personat e riadhesuar, përfshirë pagesën e qerasë, por për arsye të emigrimeve të shpeshta, në procesin e riadhesimit të tretë, nuk i ka shfrytëzuar skemat e riintegrit, duke e pamundësuar mbështetjen për riintegrim të qëndrueshëm. Përfaqësuesja e MPB-së në përgjigjen e dërguar IAP-së gjithashtu pohoi se, për shkak të ndjeshmërisë së rastit dhe cenueshmërisë, kjo Ministri është e gatshme ta rregullojë sërish çështjen e Z. S. në qendrën e akomodimit, t’i sigurojë viktimës trajtim psiko-social dhe mbështetje adekuate sipas nevojës.
6. Më 29 maj 2019, portali online “Koha.net” publikoi lajmin me titull: “Policia mohon se gruaja rome ka kryer vepra penale, fotografinë e saj e shpërndanë për tallje disa të rinj”. Sipas shkrimit në këtë portal, viktima në fjalë është identifikuar nga Policia e Kosovës dhe e njëjta është liruar, sepse ajo nuk dyshohet për asnjë vepër penale. Sipas informatave të Policisë së Kosovës, të cilat i ka publikuar ky portal, bëhet e ditur se gjithçka ka nisur si tallje nga nxënës të shkollave të mesme, të cilët e kanë fotografuar këtë person, mandej duke e shpërndarë nëpër rrjete sociale me porosinë se duhet pasur kujdes prej këtij personi.<sup>2</sup> Sipas këtij mediumi, grupe të ndryshme në rrjetet sociale kanë alarmuar rrejshëm për rrezikun që paraqet një grua, e cila është parë në qytete të ndryshme të Kosovës.<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Sipas artikullit: “Gruaja rome që po sulmohet: Kjo është historia e saj, erdhi nga Belgjika dhe u bë viktimë e rrjeteve sociale”, i publikuar nga portali “Gazetametro.net”, më 1 qershor 2019.

<sup>2</sup>Sipas artikullit: “Policia mohon se gruaja rome ka kryer vepra penale, fotografinë e saj e shpërndanë për tallje disa të rinj”, i publikuar nga portali “Koha.net”, më 29 maj 2019.

<sup>3</sup>Sipas artikullit: “Disa të rinj në Lipjan sulmojnë gruan rome, njëri e rrëzon përtokë me grusht pas koke”, i publikuar nga portali “Koha.net”, më 29 maj 2019.



7. Në të njëjtën datë, portali “*Koha.net*” publikoi lajmin me titull: “*Disa të rinj në Lipjan sulmojnë gruan rome, njëri e rrëzon përtokë me grusht pas koke*”.
8. Më 30 maj 2019, në media u paralajmërua protestë dhe e njëjta u mbajt në Prishtinë në shenjë solidariteti me viktimën Z. S. dhe kundër sulmit të ushtruar në të. Pjesëmarrësit në këtë protestë e vlerësuan se sulmi ndaj personit në fjalë është kryer nga persona, mes tjerash, me mendësi homofobe dhe kërkuan nga institucionet shtetërore që të ndërmarrin veprime të menjëhershme ndaj kryerësve të mundshëm.<sup>4</sup>
9. Më 31 maj 2019, përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët i përfaqësojnë interesat e komunitetit rom, gazetarë, studentë dhe intelektualë, dorëzuan Letër Publike në Komisionin e Pavarur për Media, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Institucionin e Avokatit të Popullit përkitazi me sulmet e fundit, siç pohuan ata, kundër pjesëtarëve të komunitetit rom në Kosovë. Përmes kësaj letre, mes tjerash, ata kërkuan që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete me qëllim të parandalimit të rasteve të tilla.
10. Më 31 maj 2019, Avokati i Popullit mori informatë se znj. Z. S. përsëri është sulmuar fizikisht në qytetin e Ferizajt. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u takuan me komandantin e Stacionit Policor (SP) në Ferizaj, nga i cili morën informatë se në këtë stacion policor është hapur rasti *Sulm ndaj personit* dhe është identifikuar një person si kryerës i mundshëm i sulmit, kurse, në koordinim me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, pritet vendosja në strehimore e viktimës Z. S.
11. Ekipi mjekësor nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare kishte shkuar në SP në Ferizaj me ftesë të zyrtarëve policorë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve mjekësore për viktimën, por ajo i kishte refuzuar. Gjithashtu komandanti i SP në Ferizaj i informoi përfaqësuesit e IAP-së se komunikimi me viktimën është i vështirë, meqenëse ajo nuk komunikon në gjuhët zyrtare, por vetëm në gjuhën angleze si dhe në atë gjermane.
12. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kërkuan informatë nga komandanti i këtij SP nëse viktimës i është siguruar ndonjë përkthyes i gjuhës angleze apo i gjuhës gjermane, por morën informatën se në këtë stacion policor nuk ka të punësuar asnjë përkthyes të gjuhës angleze dhe as të gjuhës gjermane. Gjithashtu u kërkua informatë nëse gjatë intervistimit të viktimës kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e Qendrës për Punë Sociale (QPS) dhe psikologu, më ç’ rast morën informatën se gjatë intervistimit të viktimës ka qenë i pranishëm vetëm një përfaqësues nga QPS-ja. Gjithashtu përfaqësuesit e IAP-së, gjatë kohës sa ishin të pranishëm në stacion policor, morën informatën se është kapur personi i dyshuar si kryerës i mundshëm i sulmit kundër viktimës Z. S. në Ferizaj. Mjekët pohuan se viktimë ka një lëndim të lehtë në faqen e djathtë. Gjithashtu, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit bisedoi me përfaqësuesin e QPS-së në Ferizaj, i cili pohoi se ata nuk kanë psikolog të angazhuar, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe në raste të tilla kërkojnë ndihmën e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Por sipas tij, psikologët e kësaj qendre punojnë nga ora 8:00 e mëngjesit deri në orën 14:00 pasdite, prandaj atë ditë nuk ishin të pranishëm, pasi që orari i tyre i punës kishte përfunduar. Gjithashtu, përfaqësuesi i QPS-së në Ferizaj pohoi se, në raste të tilla, Zyra e Mbrojtësit të

---

<sup>4</sup> Sipas artikullit: “*Sulmi ndaj gruas rome, sot në Prishtinë protestë kundër homofobisë*”, i publikuar nga portali “*klankosova.tv*”, më 30 maj 2019.



Viktimave nuk ftohet, por i njëjti ftohet vetëm në rast të paraqitjes së ndonjë rasti si dhunë në familje.

13. Përfaqësuesve të Avokatit të Popullit u mundësua takimi me viktimën në zyrën e intervistimit ku ajo ishte duke qëndruar në Stacionin Policor në Ferizaj. Ajo dukej se ishte jashtëzakonisht e tensionuar, shprehej në gjuhën angleze se ajo nuk ishte e sulmuar nga askush dhe kërkesa e saj ishte që ajo të lirohej dhe të dilte jashtë SP-së. Gjatë kësaj kohe i pranishëm në zyrën e intervistimit ishte edhe përfaqësuesi i QPS-së në Ferizaj, si dhe një nëpunëse e Stacionit Policor në Ferizaj, e cila mundohej ta kryente punën e përkthyeses nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Më vonë, në SP në Ferizaj ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i Zyrës për Mbrojtje të Viktimave në Ferizaj si dhe disa deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga komunitetet rom dhe egjiptian. Viktima Z. S. u vendos të strehohet në strehimore në Ferizaj dhe të jetë në përkujdesje të Policisë së Kosovës deri më datën 3 qershor 2019 dhe pas kësaj date, në pajtim me Kryeprokurorin e PThF-së, të shqyrtohet mundësia e ndërmarrjes së veprimeve adekuate të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.
14. Sipas dokumentacionit të QPS-së në Ferizaj, të cilin e ka Avokati i Popullit, shihet se zyrtarët e strehimores në të cilën është strehuar viktima Z. S. më 1 qershor, më 2 qershor dhe më 3 qershor 2019, i kanë ofruar asaj trajtim psiko-social, por që është refuzuar nga ajo.
15. Më 31 maj 2019, përkitazi me sulmin kundër viktimës Z. S. reagoi edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). Ata shprehen shqetësimin e tyre lidhur me publikimin e lajmeve të pa verifikuara, të cilat, sipas AGK-së, sjellin pasoja si në rastin e gruas, për të cilën u raportua si e “rrezikshme” dhe që “po kidnapon fëmijë”. AGK-ja theksoi se kjo formë e raportimit është shkelje e të drejtave të njeriut dhe në kundërshtim me standardet profesionale gazetareske dhe në kundërshtim me Kodin e Etikës.
16. Sipas analizimit të dokumentacionit të pranuar nga QPS-ja në Ferizaj, mund të kuptohet se QPS-ja në këtë komunë nuk ka parashtruar kërkesë për urdhër kujdestarie për viktimën Z. S. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi me njërin nga zyrtarët e QPS-së në Ferizaj, i cili pohoi se, për shkak të kompetencës territoriale, ata nuk kanë parashtruar kërkesë në gjykatë për urdhër kujdestarie, pasi që e kanë kuptuar se viktima Z. S. është banore e komunës së Podujevës.
17. Sipas informatave të Avokatit të Popullit, Gjykata Themelore në Ferizaj ia ka caktuar masën e paraburgimit prej 30 ditësh personit të dyshuar për sulm kundër viktimës.
18. Më 3 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit zhvilloi një takim informues me zyrtarët në Stacionin Policor (SP) në Lipjan lidhur me sulmin që kishte ndodhur kundër viktimës Z. S., më 29 maj 2019, në qytetin e Lipjanit. Sipas informatave të Policisë së Kosovës, SP në Lipjan ka hapur rast për hetime. Bazuar në dokumentacionin e pranuar nga SP në Lipjan, kuptohet se një punonjës në këtë stacion, më 29 maj 2019, në orën 14:21, ka njoftuar përmes postës elektronike disa zyrtarë policorë, sipas të cilit, nga ora 10:00, ka marrë informata dhe thirrje telefonike nga shumë qytetarë se në qytetin e Lipjanit është parë një grua, e cila i ngjanë në pamje postimit në rrjete sociale dhe e etiketuar si person që kishte rrëmbyer fëmijë.
19. Megjithatë, PK-ja e liroi viktimën Z. S. nga Stacioni Policor në Lipjan, por rreth orës 17:20, në po këtë stacion është pranuar informatë se në rrugën “Skënderbeu” disa të mitur



po e ngacmonin verbalisht dhe po e sulmonin një person të gjinisë femërore. Sipas dokumentacionit të pranuar nga SP në Lipjan, zyrtarët policorë kishin dalë në vendngjarje dhe kishin tentuar të komunikonin me Z. S., mirëpo ajo nuk kishte pranuar të fliste, ndërsa, gjithnjë sipas përshkrimit të zyrtarit policor, nuk është vërejtur se kishte lëndime. Gjithashtu, sipas informatave të PK-së, nga baza në PK ishte udhëzuar që personi Z. S. të dërgohej në stacionin e autobusëve në drejtim të Prishtinës, sepse në bazë të dokumenteve rezultonte se vendbanimi i saj ishte Podujeva.

20. Më 6 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pranoi dosjen e rastit nga SP në Ferizaj, nga ku kuptohet se, më 1 qershor 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj ka marrë Aktvendimin PPRM.nr.73/19, përmes të cilit i është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh personit që dyshohet se e sulmoi viktimën Z. S.
21. Më 13 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ishte në strehimoren në Prishtinë. Zyrtarët nga kjo strehimore pohuan se më 3 qershor 2019, viktima Z. S. është sjellë në këtë strehimore me iniciativën e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sipas tyre, viktima Z. S. duhet vendosur në ndonjë vend më të qëndrueshëm. Sipas informatave të IAP-së, menaxherja e rastit nga QPS-ja në Podujevë, deri më tani nuk e ka vizituar asnjëherë në strehimore viktimën Z. S.
22. Po të njëjtën datë, më 13 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me zyrtarët nga Këshilli i Pavarur për Media (KPM). Ata pohuan se, bazuar në ligjin aktual për KPM-së, nuk kanë mandat të veprojnë ndaj portaleve por vetëm ndaj medimeve televizive dhe radiove. Në pyetjen e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit se çfarë masa kanë ndërmarrë ndaj medimeve televizive që kanë shfaqur foto dhe video të sulmit kundër viktimës Z. S., zyrtarët nga KPM-ja pohuan se ka pasur një reagim publik të KPM-së dhe se Komisioni i mandatuar brenda KPM-së pritet të vendosë për ndonjë masë eventuale disiplinore ndaj TV-ve që transmetuan lajmet lidhur me znj. Z. S., përfshirë edhe incizimin e sulmit kundër saj në Lipjan dhe në Ferizaj. Ata pohuan se një njoftim për të tilla publikime u është dërguar disa mediave dhe tani presin prej tyre të përgjigjen për këtë çështje. Sipas tyre, pritet ndryshimi i ligjit të tanishëm për KPM-në dhe flitet që për t'u themeluar një portal, duhet të marrë autorizim nga KPM-ja. Gjithashtu, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka kërkuar informata shtesë për ndërmarrjen e veprimeve të tjera nga KPM-ja përkitazi me rastin. Sipas informatave të marra nga ky institucion, si veprim paraprak, KPM-ja reagoi publikisht për shkeljen e Kodit të Etikës gjatë raportimeve të disa mediave në rastin konkret dhe në njërën nga mbledhjet e Komisionit në KPM-së u shqyrtuan veprimet e disa kanaleve televizive që e transmetuan rastin në fjalë, me ç' rast KPM-ja, në pajtim me Ligjin për KPM-në dhe me Kodin e Etikës, që është në fuqi, vendosi që palët përgjegjëse të sanksionohen me Vërejtje. Gjithashtu, sipas KPM-së, palët përgjegjëse obligohen që në të ardhmen t'ia kushtojë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe të integritetit të personave të dyshuar, në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Kodin e Etikës, që është në fuqi.
23. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi menaxheren e caktuar për rastin në fjalë nga QPS-ja në Podujevë. Ajo pohoi se, si menaxhere e këtij rasti, ende nuk e ka vizituar viktimën Z. S. në strehimoren në Prishtinë, duke shtuar se ajo vazhdimisht ka kontakte përmes telefonit me drejtoreshën e kësaj strehimoreje. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ia kërkoi asaj dokumentacionin (dosjen) e rastit, të cilën e mori nga QPS-ja në Podujevë.



24. Më 19 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi përfaqësuesen nga administrata e Prokurorisë së Shtetit, e cila kërkoi që t'i dërgohet letër përmes postës elektronike lidhur me rastin.
25. Më 21 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike, i dërgoi shkresë përfaqësuesit të Prokurorisë së Shtetit, përmes së cilës kërkoi informata për veprimet e ndërmarra nga prokuroria lidhur me rastin.
26. Më 26 qershor 2019, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u takuan me përfaqësuesin nga Prokuroria e Shtetit. Meqenëse për herë të parë zonja Z. S. ishte fotografuar në Stacionin e Autobusëve në Malishevë nga disa persona, përfaqësuesi nga Prokuroria e Shtetit telefonoi Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, i cili pohoi se nuk ka informata përkitazi me marrjen e veprimeve ndaj personave që postuan dhe publikuan në rrjete sociale fotografinë e znj. Z. S. Gjithashtu, përfaqësuesi i Prokurorisë së Shtetit telefonoi Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përkitazi për veprimet në rastin e sulmit të parë në Lipjan kundër znj. Z. S. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Shtetit pohoi se do ta informojë IAP-në përkitazi me informatat e tjera lidhur me rastin në fjalë.
27. Më 27 qershor 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori informatën nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Shtetit, sipas të cilit, për rastin e sulmit kundër viktimës Z. S. në Lipjan është caktuar prokurori i rastit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, me nr. të lëndës PPM.I.Nr.211/19. Por nga komunikimet me përfaqësuesin e Prokurorisë së Shtetit mund të nxirret përfundimi se nuk është hapur ndonjë rast nga ky institucion kundër personave që për herë të parë publikuan fotografitë dhe mesazhet për znj. Z. S., të cilat rezultuan si të pavërteta, si dhe kundër mediave që publikuan fotografitë dhe kundër mediave televizive nëpër kanalet e të cilave u publikua video-incizimi i sulmit kundër viktimës në fjalë.
28. Më 29 qershor 2019, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, me pjesëmarrjen edhe të psikologes nga IAP-ja, vizituan për herë të dytë strehimoren në të cilën është duke qëndruar viktimja Z. S. Përfaqësuesja e kësaj strehimoreje i informoi përfaqësuesit e Avokatit të Popullit se viktimja Z. S. është vizituar nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë dhe asaj i janë ofruar shërbimet mjekësore. Përfaqësuesja e strehimores kërkoi disa herë nga psikiatri i Qendrës së Shëndetit Mendor në Prishtinë, i cili është edhe udhëheqës i Qendrës, ta vizitojë viktimën. Sipas njoftimit të strehimores, më 1 korrik 2019, viktimja është vizituar nga psikiatri i Qendrës së Shëndetit Mendor në Prishtinë dhe se pritet raporti për gjendjen e saj psikiatrike.
29. Më 5 korrik 2019, përfaqësuesja e strehimores e njoftoi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit për vlerësimin psikiatrik-psikologjik të viktimës dhe pas ofrimit të shërbimeve mjekësore në institucionet shëndetësore, viktimja Z. S. është kthyer sërish në strehimore në Prishtinë.
30. Më 8 korrik 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamentit për të Mitur, shpalli aktvendim ndaj një të pandehuri të mitur, duke shqiptuar masën edukative: dërgimi në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej një (1) viti, ndërsa me aktvendim të njëjtit i është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.
31. Më 11 shtator 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike, kërkoi informata shtesë nga përfaqësuesi i PK-së përkitazi me ofrimin e shërbimeve të përkthimit për personat në PK, sikurse në rastin e viktimës Z. S., kur ata nuk njohin asnjë



gjuhë zyrtare në Kosovë; kërkoi po ashtu informata se a ka ndonjë protokoll të gjuhës në PK në raste të tilla. Më 24 shtator 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike, mori përgjigje nga përfaqësuesi i PK-së, sipas të cilit, referuar dispozitave ligjore në fuqi, përfshirë Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe nenin 24, par. 2.1, të Rregullores për Operativë në Policinë e Kosovës, është formuluar *Njoftim Udhëzuesi për Policinë e Kosovës*, si informacion për të dyshuarin dhe njoftimin për të drejtat e personit të arrestuar, në pikën 4 të Udhëzuesit është përcaktuar përkthyesi, ku shkruan : “*Ju keni të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk e kuptoni ose flisni gjuhën e përdorur nga zyrtari policor.*” Gjithashtu, në këtë përgjigje të PK-së thuhet se, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore dhe në drejtim të ndalimit të diskriminimit mbi baza gjuhësore, Policia e Kosovës çdo personi që intervistohet nga ana e policisë, i cili nuk e flet gjuhën me të cilën zhvillohet procedura, e informon se ka të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, nëse nuk e kupton apo nuk e flet gjuhën e përdorur nga zyrtari policor.

32. Së fundmi, sipas Njoftimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Podujevës, i datës 13 nëntor 2019, Z. S. është vendosur në një shtëpi me qira në Podujevë për një periudhë kohore prej katër muajsh dhe pagesa e qirasë mbështetet nga Komuna e Podujevës.

## II. INSTRUMENTET RELEVANTE LIGJORE

33. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 1, par. 2, përcakton: “*Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.*”
34. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) përcakton si në vijim:
- “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*”
- “*Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*”
35. Neni 27 i Kushtetutës përcakton: “*Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.*”
36. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 35 [Liria e Lëvizjes], par. 1, përcakton: “*Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirish në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.*”
37. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] përcakton: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*”
38. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1 [Qëllimi], përcakton: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor,*



*orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*

39. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 3, par. 1 [**Koncepti i diskriminimit**], përcakton: “*Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*”; dhe par. 2 përcakton: “*Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çenoi njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*”
40. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, par. 1.4 [**Llojet e trajtimit të pabarabartë**], me termin “*Nxitja për të diskriminuar*” konsiderohet: “*Konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje.*”; dhe par. 1.10 “**Diskriminimi i shumëfishtë**”: “*Ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluar me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat.*”
41. Kodi Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, në nenin 202, par.1 [**Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara**], përcakton: “*Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.*”
42. Kodi nr. 04/L-123, neni 6, par. 3, përcakton: “*Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit.*”
43. Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në nenin 1, përcakton qëllimin e ligjit në fjalë: “*Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Mediave (në tekstin e mëtejme: KPM) me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuale që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.*”
44. Neni 3, par. 1, i këtij ligji përcakton: “*KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.*”
45. Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OShM) në Republikën e Kosovës, KKPM-2016/03, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media (më tej: Kodi), neni 1, përcakton: “*Kodi i Etikës ka për qëllim përcaktimin e rregullave të etikës për Ofruesit e*



*Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike; në pajtim me parimet etike, standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe respektin ndaj diversitetit të trashëgimisë etnike, kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës; për interesa të sigurisë kombëtare; të integritetit territorial dhe të sigurisë publike; për parandalimin e trazirave dhe të krimit; për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim dhe për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë.”*

46. Kodi, neni 3, par. 1, përcakton: “OSHM-të nuk duhet të transmetojnë ndonjë material që promovon ose nxitë krimin dhe aktivitetet kriminale ose që përmban rrezikun e shkaktimit të dëmit që mund të rezultojë me vdekje, lëndim, dëmtim të pronës apo ndonjë formë tjetër të dhunës.”
47. Kodi, neni 6, par. 1, përcakton: “OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues.” Kurse par. 5 përcakton: “OSHM-të e kanë obligim profesional që menjëherë të korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar që është gjetur të jetë i pasaktë dhe të pranojnë gabimin e tyre. Korrigjimet duhet të planifikohen në mënyrë të përshtatshme.”
48. Kodi, neni 7, par. 3, përcakton: “OSHM-të nuk duhet të transmetojnë materiale që identifikojnë personat e arrestuar apo ndaluar që sulmohen fizikisht apo verbalisht në mënyrë që i përul apo poshtëron ata.”
49. Kodi, neni 11, par. 1, përcakton: “Shkeljet eventuale të dispozitave të këtij Kodi do të procedohen dhe sanksionohen sipas Ligjit të KPM-së.”
50. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 1, përcakton: “Ky ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.”
51. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 3, par. 1.1, termi “**E dhënë personale**” ka këtë kuptim: “Çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.”
52. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 3, par. 1.17, termi “Pëlqim i subjektit të të dhënave” ka këtë kuptim: “Shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklarament ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të.”
53. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 3, par. 1.25, termi “**Të dhëna personale të ndjeshme**” ka këtë kuptim: “Të dhëna personale që zbulojnë



origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin. Karakteristikat biometrike, gjithashtu, konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme, nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf.”

54. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 5, par. 1, përcakton: “Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme:
- 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; [...].*
55. Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, neni 2, par. 2, përcakton: “Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.”
56. Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, neni 7, par. 1, përcakton: “Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.”
57. Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, neni 10, me të cilin përcaktohen detyrat e përgjithshme të policisë, përcakton si në vijim: “Të mbrojtë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat [...]”.
58. Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, neni 20, par. 1 [Ndalimi i përkohshëm policor], përcakton: “Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme:
- 1.1. ta mbroj personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s’ka mundësi për t’u mbrojtur; [...].*
59. Ligji nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, neni 1, par. 1, përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është krijimi dhe funksionalizimi i programit për kompensim të viktimave të Krimit.”; ndërsa neni 2 përcakton: “Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar të viktimave të veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e të drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkuftare.” Më tutje Ligji në nenin 6, par. 1, përcakton: “Veprat e dhunshme të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme sipas këtij Ligji janë:[...] “dhunimi”.”; ndërsa par. 2 përcakton: “Përveç veprave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, Komisioni mund të shqyrtojë dhe vendosë për kërkesat e pranuar nga personat të cilët pretendojnë se janë viktimë të veprave tjera të dhunshme të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe pasojës së shkaktuar mund të arsyetojnë kompensimin sipas këtij Ligji, në veçanti nëse viktimë është viktimë e ndjeshme.”
60. Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, neni 16, par. 1, përcakton: “Çdo person që merr pjesë në procedurat penale dhe në procedura të tjera gjyqësore, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën (t) e procedurave, ka të drejtë të përdorë gjuhën e tij apo të saj në procedura.”



16.2. "Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që marrin pjesë në procedura penale dhe procedurë penale dhe ne procedurat tjera gjyqësore, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në procedura."

16.3. "Gjykata dhe organet për ndjekje penale si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni."

17.1. "Çdo person që merr pjesë në procedura penale, i cili nuk flet ose nuk kupton gjuhën(t) e procedurave, ka të drejtë të paraqesë shkresat, të dëshmojë dhe të dëgjojë faktet e rastit dhe të çdo dëshmie kundër tij apo saj, në gjuhën e folur nga ai apo ajo."

17.2. "Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që marrin pjesë në procedura penale, kanë të drejtën të paraqesin shkresat, të dëshmojnë dhe të dëgjojnë faktet për rastin dhe çdo dëshmie kundër tyre, në gjuhën e tyre amtare."

17.3. "Gjykatat apo organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurën penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni."

61. Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 1, me termin "**Nëpunës i shërbimeve sociale**" nënkupton: "Një profesionist të shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose në ndonjë lëmë tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në regjistër të Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare."
62. Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 1, paragrafi 3, përcakton: "Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të [...] rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë[...]."
63. Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 7, par. 6, përcakton: "QPS-ja është e obliguar të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose familje që jeton ose gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë prej saj ose në ndonjë mënyrë tjetër mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare."
64. Neni 13, paragrafi 1, i këtij ligji, "Mbrojtja e të rriturve në rrezik", përcakton: "Në rastet kur një QPS vihet në dijeni se ka dëshmi se një i rritur nuk është në gjendje të përkujdeset për veten për arsye të aftësive të kufizuara mendore ose është i lënë pasdore, i shfrytëzuar ose abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës, dobësisë ose aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, frikës se ata do ta dëmtojnë, ose për shkak të faktorëve të tjerë është i rrezikuar deri në atë masë sa që i mungon zotësia që të veprojë në emër të vet, drejtori i qendrës për punë sociale në territorin ku ai/ajo jeton ose gjendet, duhet të ndërmarrë pa vonesë të gjitha hapat e nevojshëm për sigurinë e tij" dhe paragrafin 2. "Nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, drejtori i qendrës



*përkatëse për punë sociale duhet të paraqesë pranë gjykatës kërkesën për një urdhër kujdestarie.”*

65. Ligji nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës, nenit 3, përcakton: “*Sigurimi i banimit bëhet përmes programeve të veçanta të banimit.*”, ndërsa neni 19, par. 1.2, i këtij ligji përcakton: “*Programet e banimit mund të financohen nga: [...] të hyrat e Komunës të dedikuara për banim.*”
66. Ligji në fjalë, neni 25 [Përgjegjësitë e komunave], par. 1, përcakton se për zbatimin e këtij ligji, Komuna bën: “*Identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji.*”; kurse par. 2 përcakton se Komuna bën: “*Hartimin e programeve dhe projekteve tre (3) vjeçare për banim, bazuar në burimet financiare.*”; dhe par. 3 përcakton se Komuna bën: “*Sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit.*”
67. Gjithashtu, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17, thekson: “*Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë: pika k): “Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale”; pika l): “banimin publik”.*

### III. ANALIZA LIGJORE

68. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 1, par. 2, përcakton se *Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet* dhe si e tillë *Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj*. Raportimi i mëhershëm për znj. Z. S. se është burrë i veshur si grua, pra në atë kohë flitej për disa informata mbi orientimin seksual, krijoi paragjykime të ndryshme homofobe. PK-ja, por edhe mediat, publikuan informatën përkitazi me përkatësinë etnike të personit Z. S. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e të gjitha institucioneve se Kushtetuta përcakton qartë se *Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet* dhe në të tilla raste mjafton të përcaktohet shtetësia e personit/personave.
69. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë këtu edhe institucionet e ndjekjes, ato policore si dhe ato që ofrojnë shërbime sociale.
70. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 35 [Liria e lëvizjes], par. 1, përcakton: “*Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.*” Liria e lëvizjes, si një nga të drejtat themelore të çdo njeriu, është proklamuar edhe në



nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Bazuar në këtë instrument ndërkombëtar mund të kuptohet se secilit, që legalisht gjendet në territorin e një shteti, i garantohet e drejta e lirisë së lëvizjes dhe e zgjedhjes së vendbanimit në kufijtë e atij shteti.

71. Në kuptim të dispozitës së nenit 3 të Konventës, Avokati i Popullit rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me po këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Evropiane).
72. Gjykata Evropiane ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se ky përbën një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ajo ndalon në terma absolutë torturën ose dënimet apo trajtimet çnjerëzore e poshtëruese, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës. Trajtimi është konsideruar të jetë “poshtërues” brenda kuptimit të nenit, kur ai ka për qëllim të poshtërojë ose të përlulë një person, duke treguar një mungesë të respektit dhe fyerje për dinjitetin e tij, dhe konsiderohet se shkakton tek viktima ndjenja frike, ankthi apo inferioritetit, që çojnë në thyerjen e rezistencës së tij morale dhe fizike. Por Gjykata Evropiane rikujtoi se, edhe në rast të mungesës së një qëllimi të tillë, nuk mund të përjashtohet përfundimisht shkelja e nenit 3. Ajo vuri në dukje veçanërisht se natyra publike e trajtimit mund të jetë një faktor relevant ose rëndues në vlerësimin nëse trajtimi është “poshtërues” brenda kuptimit të nenit 3, (shih rastin *Svinarenko dhe Slyadnev kundër Rusisë*, i datës 17 korrik 2014).
73. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 1, përcakton qëllimin e këtij ligji, sipas të cilit ky ligj ka për qëllim: “Përcaktimin e një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.” Gjithashtu, ky ligj përcakton llojet e trajtimit të pabarabartë, ndër to, nxitjen për të diskriminuar, që konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një 1 të këtij ligji, dhe përfshin **çdo promovim të urrejtjes** kur ajo bëhet me dashje si dhe përcakton **diskriminimin e shumëfishtë**, i cili ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj<sup>5</sup>. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ngre shqetësimin se viktima Z. S. edhe pse emri dhe mbiemri i saj u paraqit nga PK-ja dhe nga mediat përmes inicialeve, PK-ja nuk do të duhej që ta përcaktonte përkatësinë etnike apo ndonjë veçori tjetër të viktimës/viktimave në deklaratat e tyre publike. Publikimi i informatave të tilla është në kundërshtim edhe me Ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të cilën pjesë do të flitet më poshtë.
74. Kodi Penal i Kosovës përcakton: “**Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit dënohet me gjobë ose me burgim prej një**

<sup>5</sup> Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, par. 1.4 dhe par. 1.10.



(1) deri në tre (3) vjet <sup>6</sup>.” Pra, Kodi Penal ndalon, kushdo qoftë ai/ajo, që pa autorizim kryen një veprim të tillë. Në rastin konkret ka mjaftuar një qasje e thjeshtë në rrjete sociale në internet apo në disa portale dhe të shohësh në video sulmin e shkaktuar kundër saj, në të dyja rastet - në Lipjan dhe në Ferizaj. Gjithashtu, fotografitë e viktimës janë shpërndarë me dhjetëra herë gjithandej nëpër rrjete sociale dhe nëpër portale, përfshirë edhe në media televizive.

75. Publikimi i lajmeve të pasakta dhe të paverifikueshme, sikurse nga disa media, po ashtu edhe publikimi i pohimeve nga disa të rinj se kinse viktimja është e rrezikshme, vjedh fëmijë, si dhe pohime të tjera të pavërteta, do të duhej të ishin alarm për organet e ndjekjes (Prokurorin e Shtetit) për fillimin e procedurës penale. Avokati i Popullit thekson se Prokuroria e Shtetit ende nuk ka hapur rast për fillimin e hetimeve ndaj mediave dhe personave që kanë publikuar informata të pasakta, ashtu si është e përcaktuar me Kodin nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i cili në nenin 6, par. 2, përcakton: *“Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale.”*
76. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës përcakton: *“Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të të dëmtuarit.”* Avokati i Popullit vlerëson se të dhënat e publikuara në media për këtë rast konsiderohen si të mjaftueshme që Prokurori i Shtetit t’i fillojë hetimet përkitazi me publikimin e të dhënave personave, fotografisë, video-incizimeve të sulmeve të shkaktuara kundër viktimës Z. S.
77. Protokollin e Këshillit të Evropës (2003) për gjuhën e urrejtjes, që ishte miratuar në zbatim të Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës me qëllim të luftimit të urrejtjes në internet. Dy objektivat themelore të këtij protokollin janë harmonizimi i së drejtës penale në luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë në internet, dhe e dyta, avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Sipas protokollit, gjuha e urrejtjes në internet nënkupton: *“Kërcënimin e motivuar racist ose ksenofobik përmes sistemit kompjuterik.”* Ndërsa si material racist dhe ksenofobik konsiderohet: *“Çdo material i shkruar, çdo fotografi ose çdo prezantim tjetër të ideve dhe teorive, të cilat përfaqësojnë, promovojnë ose nxisin urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër individit ose grupit të individëve, të bazuara në: racë, ngjyrë, paraardhës ose prejardhje kombëtare apo etnike, si dhe religjioni nëse përdoret si pretekst për cilindo qoftë nga këta faktorë.”*
78. Duhet theksuar se kjo bazë është pranuar edhe në shumicën e ligjeve penale të shteteve, duke inkriminuar si vepër penale nxitjen e urrejtjes (siç është edhe përcaktimi i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht vepra penale “Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit” (neni 141).
79. Duke u bazuar në informatat e pranuar nga përfaqësuesit e KPM-së, Ligji aktual për Komisionin e Pavarur për Media këtij institucioni nuk ia jep kompetencat për monitorimin e portaleve online në internet, Avokati i Popullit do ta vë theksin në analizën ligjore për sa i përket kryesisht televizioneve dhe obligimet e përcaktuara në Ligjin

<sup>6</sup> Kodi Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, neni 202, par. 1.



nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media si dhe në Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OSHM) në Republikën e Kosovës, KKPM-2016/03. Avokati i Popullit thekson se shumë kanale televizive kanë shfaqur fotografi dhe incizime të sulmeve në Lipjan dhe në Ferizaj të shkaktuara kundër viktimës. Të tilla imazhe edhe sot e kësaj dite janë të qasshme për publikun.

80. Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili ka si qëllim përcaktimin e kompetencave të KPM-së dhe promovimin e zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuale, që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, KPM-në e përcakton si organ të pavarur, i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale, kurse Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OSHM) në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 përcakton rregullat bazë të ofruesve të shërbimeve mediale.
81. Sipas këtij Kodi, OSHM-të nuk duhet të transmetojnë ndonjë material që promovon ose nxit krimin dhe aktivitetet kriminale ose që përmban rrezikun e shkaktimit të dëmit që mund të rezultojë me vdekje, lëndim, dëmtim të pronës apo me ndonjë formë tjetër të dhunës. Pamjet e publikuara nëpër disa kanale televizive në Kosovë, që shfaqin sulmet në Lipjan dhe në Ferizaj që kanë ndodhur kundër viktimës, janë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në këtë Kod.
82. Sipas këtij Kodi, OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet ta dinë se është i pavërtetë ose mashtrues. Disa media raportuan se personi është i rrezikshëm dhe rrëmbyes fëmijësh. PK-ja ndaloi viktimën ku pas verifikimit në sistemin e PK-së rezultoi se ky person nuk ka ndonjë të kaluar kriminale dhe nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore<sup>7</sup>.
83. Në vendet demokratike, parimisht, liria e shprehjes, përkatësisht liria e mediave është e garantuar (me kushtetutë dhe me ligje) nga abuzimi i atyre që kanë pushtet, dhe nuk mund të ketë censurë të kësaj të drejte fundamentale. Por në të gjitha vendet demokratike, me ligj përcaktohen edhe limitet e shfrytëzimit të kësaj të drejte për të shmangur abuzimin, në veçanti në lidhje me shpifjen dhe fyerjen përmes mediave, dhënien e lajmeve të pavërteta me qëllim të dëmtimit të dinjitetit dhe të reputacionit të një personi, përhapjen e gjuhës së urrejtjes, cenimin e sigurisë publike etj.
84. Gjykatat, mekanizmat dhe konventat ndërkombëtare dhe rajonale për të drejta të njeriut pranojnë se liria e të shprehurit mund të kufizohet me ligj në mënyra të caktuara, rreptë të përcaktuara dhe në rrethana të veçanta. Kufizimet gjatë ushtrimit të lirisë së të shprehurit nuk mund ta vënë në rrezik të drejtën.<sup>8</sup>
85. Gjykata e Lartë në Itali, në raport me garantimin e të drejtave të tjera, sidomos mbrojtjen e dinjitetit të njeriut nga shpifjet dhe fyerja, me qëllim të kufizimit të lirisë së shprehjes, ka përcaktuar tri kritere bazike, si: vërtetësia, vetëpërmbytja dhe interesi publik.

<sup>7</sup> Sipas artikullit: "Policia mohon se gruaja rome ka kryer vepra penale, fotografinë e saj e shpërndanë për tallje disa të rinj", i publikuar nga portali "Koha.net", më 29 maj 2019.

<sup>8</sup> Shih Udhërrëfyeni i BE-së, pika 19.



86. Avokati i Popullit rikujton se shkeljet eventuale të dispozitave të këtij Kodi duhet të procedohen dhe të sanksionohen sipas Ligjit të KPM-së. Sanksionet e përcaktuara në këtë Kod, mes tjerash, përfshin vendosjen e një gjobe në vlerë jo më pak se një mijë (1.000) eurosh dhe jo më shumë se njëqind mijë (100.000) eurosh; ndryshimin e kushteve të licencës së transmetuesit; ndërprerjen apo refuzimin e licencës së transmetimit. Por në rastin konkret, KPM-ja ka vepruar duke marrë vendime përkatëse për disa kanale televizive, përmes të cilave ka shqiptuar vetëm vërejtje, duke i obliguar që në të ardhmen t'ia kushtojnë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe të integritetit të personave, sikurse që do të duhej të ndodhte edhe në rastin e viktimës Z. S.
87. Avokati i Popullit gjithashtu ngre shqetësim se publikimi në rrjete sociale dhe në media i video-incizimeve si dhe i fotografive të viktimës është në kundërshtim edhe me Ligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Publikimi i imazheve të tilla, në të cilat shihen aktet e dhunës kundër personit në fjalë, lëndon rëndë dinjitetin e viktimës. Ky ligj definoi termin *“E dhënë personale”* dhe që ka kuptimin: *“Çdo informacioni në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekti i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai i cili mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.”*. Edhe pse ky ligj nuk e përcakton shprehimisht fotografinë si e dhënë personale, megjithatë, nga zberthimi që mund t'i bëhet përkufizimit të termit të lartcekur, mund të kuptohet se, megjithatë, edhe fotografia mund të konsiderohet si e dhënë personale, sepse: *“Çdo informacioni në lidhje me një person fizik [...] të identifikueshëm, i cili mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt.”* Prandaj, Avokati i Popullit konsideron që fotografia, e aq më tepër video-incizimet e sulmeve kundër viktimës të shkaktuara në Lipjan dhe në Ferizaj, mund të jetë e dhënë personale nëse i referohemi përcaktimit të nocionit *“E dhënë personale”*, i përcaktuar në Ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sepse për publikimin e fotografisë dhe incizimeve të viktimës nuk ka ekzistuar pëlqimi i saj dhe ky ligj përcakton: *“Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret, në mesin e të cilëve:*  
*1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; [...].”*
88. Për më tepër, ky ligj definoi termin **“Të dhëna personale të ndjeshme”**, që ka kuptimin: *“Të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin.[...]”* Në rastin konkret, përveç publikimit të fotografisë dhe të video-incizimeve në të dy rastet e sulmeve kundër viktimës, edhe zbulimi i përkatësisë etnike paraqet të **dhënë personale të ndjeshme**. Prandaj, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se në këtë rast nuk është respektuar nga PK-ja dhe nga mediat ruajtja e të dhënave të ndjeshme.
89. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës përcakton se zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligje të tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës i hartuar nga PK-ja. Gjithashtu ky ligj shumë



qartë përcakton detyrat dhe kompetencat e përgjithshme të PK-së, që si detyrë parësore përcakton: *“PK duhet të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat.”* Avokati i Popullit rikujton se, para se të ndodhte sulmi i parë në Lipjan kundër viktimës më 29 maj 2019, PK-ja kishte informacione nga disa qytetarë për qëndrimin e viktimës në Lipjan, e cila mjaftueshëm ka qenë sinjal për Policinë e Kosovës që qytetarët të cilët kanë rënë pre e mashtrimit janë të shqetësuar nga prania e saj në këtë vend. Policia e kishte takuar viktimën dhe, pas verifikimit, të njëjtën e kanë liruar pa ndërmarrë ndonjë veprim konkret për ta siguruar atë pavarësisht faktit se kanë pasur informatë se qytetarët kanë rënë pre e mashtrimeve të rrjeteve sociale. Ligji për Policinë e Kosovës, neni 7, par. 1, përcakton: *“Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.”* Pra, para së gjithash, PK-ja ka **mandat parandalues**, gjë që në rastin konkret nuk vërehet se e ka përmbushur këtë obligim ligjor. Tutje, Ligji për Policinë në Kosovë, neni 20, flet për ndalimin e përkohshëm policor. Sipas këtij ligji, zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme **ta mbroj personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s’ka mundësi për t’u mbrojtur; apo personi nën ndalim të përkohshëm informohet lidhur me arsyet e mbajtjes dhe i jepet mundësia ta lajmërojë ndonjë anëtar të familjes, mbrojtësin, institucionin përkatës ose personin tjetër të besueshëm.**

90. Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka si qëllim krijimin dhe funksionalizimin e programit për kompensim të viktimave të krimit. Ky ligj rregullon të drejtën e kompensimit financiar për viktimat e veprave të dhunshme penale dhe të vartësve të tyre, autoritetet vendimmarrëse si dhe procedurat për realizimin e së drejtës për kompensim në situatat vendore dhe ndërkuftare. Më tutje Ligji përcakton se veprat e dhunshme, të cilat hyjnë në kategorinë e veprave të kompensueshme, sipas këtij Ligji janë:[...] **“dhunimi”**. Por Komisioni përkatës mund të shqyrtojë dhe vendosë për kërkesat e pranura nga personat, të cilët pretendojnë se janë viktima të veprave të tjera të dhunshme, të cilat, për shkak të natyrës së tyre dhe pasojës së shkaktuar, mund ta arsyetojnë kompensimin sipas këtij Ligji, në veçanti nëse **viktima është viktimë e ndjeshme**. Këto dispozita ligjore mund të konsiderohet si të mjaftueshme që pjesë e procedurave për kompensim të viktimave të krimit të jetë edhe viktima Z. S.
91. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë përcakton: *“Çdo person që merr pjesë në procedurat penale dhe në procedura të tjera gjyqësore, i cili nuk flet ose nuk e kupton gjuhën (t) e procedurave, ka të drejtë ta përdorë gjuhën e tij apo të saj në procedura”*. Tutje ky ligj përcakton se gjykata dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale, duhet të ofrojnë ndihmën me përkthyes pa pagesë për personat e cekur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni<sup>9</sup>. Avokati i Popullit rikujton se ky ligj jep mundësi që gjykatat dhe organet e ndjekjes penale si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale, përfshirë këtu edhe në rastin konkret Policinë e Kosovës, duhet ofruar përkthyes pa pagesë.
92. Për më tepër, referuar informatave të dërguara nga PK-ja, më 24 shtator 2019, ky institucion i referohet dispozitave ligjore, përfshirë Kodin e Procedurës Penale të Kosovës

<sup>9</sup> Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë, neni 16, par. 1 dhe 3.



dhe nenin 24, par. 2.1, të Rregullores për Operativë në Policinë e Kosovës, përmes së cilave është formuluar *Njoftim Udhëzuesi për Policinë e Kosovës*, si informacion për të dyshuarin dhe njoftimin për të drejtat e personit të arrestuar, në pikën 4 të udhëzuesit është përcaktuar përkthyesi, ku shkruan: *“Ju keni të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk e kuptoni ose flisni gjuhën e përdorur nga zyrtari policor.”* Por, Njoftim Udhëzuesi për Policinë e Kosovës i referohet personave të arrestuar dhe përfshin informatat për persona të dyshuar dhe njohjes të të drejtave të tyre, por jo personave viktimë, si në rastin konkret të viktimës Z. S. Gjithashtu, neni 24, par. 2.1, i Rregullores për Operativë në PK flet për të drejtat e personit të arrestuar, konkretisht ky nen dhe paragraf përcakton: *“Personi i arrestuar gëzon këto të drejta: Të Drejtën që të informohet për arsyet e arrestimit në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton.”*

93. Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare definon termin *“person në nevojë”* që nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, përveç tjerash, për shkak të rrezikut nga abuzimi. Edhe në rastin konkret, viktimia mund të konsiderohej person në nevojë, sepse ajo në radhë të parë ka nevojë për përkujdesje ndaj saj, ngase, sipas informacioneve që janë siguruar, ajo jeton e vetme.
94. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare në Kosovë, përkatësisht Ligjit nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, *Person në nevojë* konsiderohet cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, për shkak [...] se është *i rrezikuar nga shfrytëzimi ose abuzimi ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë*. Gjithashtu, Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare shton përkufizimin e ri për *“Qendra për Punë Sociale (QPS)”* që nënkupton se ato janë *institucione publike profesionale të nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale*, prandaj viktimat, sikurse në rastin konkret Z. S., i gëzon të gjitha të drejtat në shfrytëzimin e shërbimeve sociale nga QPS-ja, varësisht ku është gjendur ajo.
95. Pas sulmit të dytë kundër viktimës që kishte ndodhur në Ferizaj, gjatë intervistimit të saj në SP nuk ishte i pranishëm asnjë psikolog, që sipas përfaqësuesit të QPS-së në këtë qytet, e arsyetojnë me mungesë të mjeteve buxhetore. Në raste të tilla ata kërkojnë ndihmën e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, por psikologët e kësaj qendre punojnë nga ora 8:00 deri në orën 14:00, dhe në ditën kur në Ferizaj ndodhi sulmi kundër viktimës, orari i punës së psikologëve kishte përfunduar. Avokati i Popullit vlerëson se arsyetime të tilla janë të pabaza dhe se mungesa e mjeteve buxhetore nuk do të duhej të ishte pengesë për angazhimin e psikologëve në rast. Aq më tepër, prania e psikologëve në të tilla raste është e pamohueshme dhe njëherësh është obligim ligjor që çdo QPS do duhej ta respektonte. QPS-ja në Ferizaj ka pohuar se viktimës i janë ofruar më vonë seanca psikologjike vetëm në strehimore, por që viktimia i ka refuzuar.
96. Tutje Ligji përcakton: *“Në rastet kur një QPS vihet në dijeni se ka dëshmi se një i rritur nuk është në gjendje të përkujdeset për veten për arsye të aftësive të kufizuara mendore ose është i lënë pasdore, i shfrytëzuar ose abuzuar nga të tjerët për shkak të moshës,*



*dobësisë ose aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, frikës se ata do ta dëmtojnë, ose për shkak të faktorëve të tjerë është i rrezikuar deri në atë masë sa që i mungon zotësia që të veprojë në emër të vet, drejtori i qendrës për punë sociale në territorin ku ai/ajo jeton ose gjendet, duhet të ndërmarrë pa vonesë të gjitha hapat e nevojshëm për sigurinë e tij.”* Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 përcakton nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personit të rrezikuar i mungon zotësia për të vepruar në emër të vet dhe se është e nevojshme për ta mbrojtur të rriturin nga rreziku serioz, Qendra për Punë Sociale duhet ta paraqesë në gjykatë kërkesën për një urdhër kujdestarie. Bazuar në informatat e pranuar nga Avokati i Popullit, QPS-të në Lipjan dhe Ferizaj kanë pohuar se nuk kanë parashtruar kërkesa në gjykatat kompetente për dhënien e urdhrimit të kujdestarisë, me arsyetimin se nuk kanë kompetencë territoriale që ta ndërmarrin një veprim të tillë, meqenëse viktimja Z. S. është me adresë nga Podujeva.

97. Sipas komunikimeve që kishte përfaqësuesi i Avokatit të Popullit me menaxheren e rastit nga QPS-ja e Podujevës, as ky institucion nuk kishte parashtruar ndonjë propozim në gjykatën kompetente për urdhër kujdestarie. Megjithatë, ligji, ashtu siç u cek më lart, përcakton: *“Drejtori i qendrës për punë sociale në territorin ku ai/ajo jeton ose gjendet, duhet të ndërmarrë pa vonesë të gjitha hapat e nevojshëm për sigurinë e tij.”* Pra, në raste të tilla, sikurse rasti në fjalë, nuk vlen kompetenca territoriale. Ky konstatim i tillë akoma më shumë është i qëndrueshëm, pasi që ky ligj përcakton se QPS-ja është e obliguar të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose për secilën familje që jeton ose që gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë prej saj, ose në ndonjë mënyrë tjetër mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Në këtë kuptim, vërehet se shërbimet sociale dhe familjare do të mund t'i ofroheshin, në këtë rast viktimës, nga QPS-të edhe të komunave të tjera ku ajo është gjendur.

98. Ligji nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës përcakton se sigurimi i banimit bëhet përmes programeve të veçanta të banimit, përveç tjerash, mund të financohen edhe nga të hyrat e Komunës të dedikuara për banim. Ky ligj përcakton se Komuna bën identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji dhe sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit. Prandaj, mbi këtë bazë ligjore, Komuna e Podujevës do të duhej të vepronte në këtë mënyrë, duke siguruar banimin përmes programeve të veçanta për rastet e tilla sikurse tek Z. S. Për më tepër, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, përfshirë ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cënueshmit, strehimin familjar, si dhe banimin publik.

#### **IV. KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT**

99. Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, konstaton se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*, pasi që autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore dhe as standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, kundrejt ndërmarrjes së veprimeve konkrete në drejtim të mbrojtjes së jetës së viktimës Z. S., përkatësisht parandalimin e sulmit kundër



saj në Lipjan dhe në Ferizaj. Së këndejmi, Avokati i Popullit konsideron se autoritetet kompetente të shtetit nuk kanë ofruar mbrojtje të mjaftueshme për viktimën Z. S., e cila ka qenë e ekspozuar ndaj rrezikut dhe si për pasojë ajo u sulmua dy herë radhazi.

100. Avokati i Popullit konstaton se Prokuroria e Shtetit me mos hapjen e rastit për hetime me iniciativën e vet kundër personave që për herë të parë publikuan në rrjete sociale fotografinë e viktimës Z. S., si dhe publikimin e mesazheve të ndryshme nga disa media, paraqet mospërbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore.
101. Avokati i Popullit konstaton se publikimi i fotografisë dhe i video-incizimit nga disa portale dhe media televizive, pa pëlqimin e viktimës, cenon rënd dinjitetin e saj, duke poshtëruan dhe viktimizuar edhe më shumë personin në fjalë dhe, si të tilla, janë në kundërshtim me parimet etike e standardet ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë promovojnë dhe nxisin aktivitetet e tilla kriminale. Veprimet e tilla janë në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë në kundërshtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe janë në kundërshtim me Kodin e Etikës për OShM.
102. Në pajtim me standardin e përcaktuar në dokumentet ndërkombëtare, Avokati i Popullit, tërheq vërejtjen se kufizimet e lirisë së shprehjes arsyetohen deri në masën sa nuk cenohet realizimi i saj dhe vetëm sa është e domosdoshme që kjo e drejtë të mos abuzohet në dëm të të drejtave të tjera. Andaj, arritja e një ekuilibri të tillë kërkon një kujdes të posaçëm, dhe ndërtimin e një kornize ligjore dhe mekanizmi zbatues të përshtatshëm. Ky synim mund të arrihet vetëm mbi bazën e një trajtimi të thellë dhe analizës për të garantuar që liria e shprehjes, përkatësisht liria e mediave të mos abuzohet në drejtim të cenimit të dinjitetit të njeriut, privatësisë, përhapjes së gjuhës së urrejtjes, mosdurimit dhe pasojave të tjera të dëmshme.
103. Avokati i Popullit vlerëson se KPM-ja, me një shqiptim të vërejtjeve kundër disa kanaleve televizive për rastin në fjalë, vështirë se mund të ndikojnë në ngritjen e kujdesit të duhur të kanaleve të caktuara televizive për mbrojtjen e identitetit dhe të integritetit të personave viktimë në të ardhmen dhe arritjes së synimeve të tjera të përcaktuara në Ligjin në fuqi për KPM-në si dhe me Kodin e Etikës për OShM-në.
104. Avokati i Popullit konsideron se, sipas Kushtetutës, Republika e Kosovës *është shtet i shtetasve të vet* dhe, në rastin konkret, publikimet e informatave nga disa media dhe nga Policia e Kosovës rreth përkatësisë etnike të viktimës Z. S. si dhe paragjykimet për orientimin seksual të saj, janë krejtësisht të panevojshme dhe kanë ndikuar negativisht duke shkaktuar *diskriminim të shumëfishtë* dhe që si pasojë rezultoi me dy sulme të përsëritura kundër saj.
105. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet përgjegjëse dështuan në ndërmarrjen e masave në lidhje me detyrimet pozitive për viktimën Z. S. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit konstaton se Stacioni Policor në Lipjan, i cili kishte informata nga qytetarët për prezencën në këtë qytet të personit Z. S. para se të bëhej cak i sulmit, nuk i ka përmbushur *autorizimet e veta kushtetuese dhe ligjore* dhe ka dështuar në përmbushjen e detyrës parësore që është mbrojtja e jetës si dhe ofrimi i sigurisë për të gjithë personat. Si e tillë, zyrtarët policorë të SP në Lipjan nuk e kanë arritur qëllimin e tyre për parandalimin e sulmit kundër viktimës. Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se SP në Ferizaj me vonesë e ka ftuar përfaqësuesin nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave. Prania në SP e



përfaqësuesit nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave është siguruar vetëm pas kërkesës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit.

106. Avokati i Popullit vlerëson se SP në Ferizaj, nuk ka arritë që personit Z.S. t'i ofrojë përkthyes në gjuhën të cilën ajo ka komunikuar në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë, pavarësisht përpjekjes që punën e përkthyesit ta bëjë një zyrtar tjetër që nuk është i thirrur për një gjë të tillë.
107. Më 24 shtator 2019, në përgjigjen e PK-së theksohet se Kodi i Procedurës Penale të Kosovës dhe nenin 24, par. 2.1, i Rregullores për Operativë në Policinë e Kosovës, përmes së cilave është formuluar *Njoftim Udhëzuesi për Policinë e Kosovës*, si informacion për të dyshuarin dhe njoftimin për të drejtat e personit të arrestuar, në pikën 4 të udhëzuesit është përcaktuar përkthyesi, ku shkruan: *“Ju keni të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk e kuptoni ose flisni gjuhën e përdorur nga zyrtari policor.”* Por Njoftim Udhëzuesi për Policinë e Kosovës i referohet personave të arrestuar dhe përfshin informatat për persona të dyshuar dhe njohjes të të drejtave të tyre, por jo personave viktimë, si në rastin konkret të viktimës Z. S. Gjithashtu, neni 24, par. 2.1, i Rregullores për Operativë në PK flet për të drejtat e personit të arrestuar, konkretisht ky nen dhe paragraf përcakton: *“Personi i arrestuar gëzon këto të drejta: Të Drejtën që të informohet për arsyet e arrestimit në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton.”* Pra, përcakton të drejtën e personit të arrestuar dhe jo të viktimës, si në rastin konkret. Për më tepër, në këtë përgjigje të PK-së thuhet se, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore dhe në drejtim të ndalimit të diskriminimit mbi baza gjuhësore, PK-ja çdo personi që intervistohet nga policia, i cili nuk e flet gjuhën me të cilën zhvillohet procedura, e informon se ka të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, nëse nuk e kupton apo nuk e flet gjuhën e përdorur nga zyrtari policor, por pa përmendur ndonjë akt nënligjor për këtë të drejtë për personin që intervistohet nga PK-ja. Megjithatë, në rastin e intervistimit të viktimës Z. S. në SP në Ferizaj nuk ishte vepruar në këtë mënyrë, personit në fjalë nuk i ishte ofruar e drejta për ndihmë pa pagesë për një përkthyes.
108. Avokati i Popullit konstaton se QPS-të në Lipjan, në Ferizaj dhe në Podujevë nuk janë koordinuar në nivelin e nevojshëm dhe nuk kanë ofruar shërbimet sociale të nevojshme për ofrimin e sigurisë për personin Z. S., përfshirë propozimin për urdhër kujdestarie në gjykatat kompetente. QPS-të në Lipjan dhe në Ferizaj nuk kanë ofruar me kohë këshillimet psikologjike për personin në fjalë. Mosofrimi i të tilla shërbimeve sociale nga këto QPS si dhe transferimi i viktimës nga një qytet në një qytet tjetër është riviktimizim ndaj saj.
109. Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës, Komuna e Podujevës, në rastet e tilla, do të duhej të siguronte banimin përmes programeve të veçanta të banimit, pasi që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjisllacionin e zbatueshëm, përfshirë ofrimin e shërbimeve familjare dhe të shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cënueshmit, strehimin familjar, si dhe banimin publik.
110. Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime*



*dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).”; si dhe neni 18, paragrafi 1.7: “Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.”, i*

## REKOMANDON

### **Prokurorisë së Shtetit:**

- Në pajtim me autorizimet ligjore t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme ndaj të gjithë personave të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nxitën urrejtje në rrjete sociale duke publikuar fotografi dhe duke transmetuar mesazhe, të cilat nxitën dhunën kundër znj. Z.S. dhe e njëjta iu ekspozua sulmeve paragjyquese dhe të motivuara.

### **Komisionit të Pavarur për Media:**

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të ushtroi kontroll më rigoroz ndaj ofruesve të shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës. me qëllim që ata t’ia kushtojnë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe të integritetit të personave viktimë.

### **Policisë së Kosovës:**

- Në njoftimet për media dhe në komunikimet e tjera me publikun, përveç publikimit të inicialeve të emrit dhe mbiemrit të personit/personave të përfshirë në raste të ndryshme, t’i mbrojnë të dhënat e tjera personale, përfshirë të dhënat për përkatësinë etnike, me qëllim të ruajtjes dhe të mbrojtjes së identitetit të palëve të përfshira në raste.
- Të nxjerrë një rregullore apo protokoll të gjuhës, në të cilën duhet të përcaktohen dhe të konkretizohen procedurat standarde të veprimit për zbatimin e të drejtave gjuhësore të viktimave, me rastin e ndalimit të tyre nga zyrtarët policorë, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, me Ligjin për Policinë e Kosovës dhe me Kodin e Procedurës Penale.

### **Qendrave për punë sociale në Podujevë, në Lipjan dhe në Ferizaj:**

- Të ngritin nivelin e bashkëpunimit dhe të koordinimit dhe, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore në fuqi, ta vlerësojnë seriozitetin e rastit dhe shqyrtimin e mundësive të parashtrimit në gjykatën kompetente të propozimit të urdhrimit për kujdestari në raste të tilla apo të ngjashme.

### **Komunës së Podujevës:**

- Në bashkëpunim me institucione relevante, t’i ofrojë strehim të qëndrueshëm viktimës Z.S., si dhe t’i ofrojë shërbime të tjera sociale në pajtim me Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, si dhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, i cili është në fuqi.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha



*dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmermi lidhur me këtë çështje.*

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit